RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur sot, diskutoi gjendjen financiare dhe funksionale të institucionit pas tërheqjes së mjeteve nga llogaria bankare nga përmbaruesi privat, sipas vendimit të prerë të gjykatës për çështjen juridike të paditësit Grand Media, datuar në vitin 2011.

Pas shqyrtimit të raportimeve nga menaxhmenti, Bordi shpreh shqetësimin e thellë për situatën e krijuar dhe ndikimin që ajo mund të ketë në funksionimin normal të transmetuesit publik, përfshirë realizimin e obligimeve financiare dhe operacionale të RTK-së, pas tërheqjes së 950,703.60 eurove.

Bordi, së bashku me menaxhmentin e RTK-së, do të ndërmarrë të gjitha veprimet për gjetjen e modaliteteve për mbrojtjen e interesit të RTK-së. Bordi i RTK-së kërkoi auditimin e dosjes posa të kompletohet Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Në të njëjtën kohë, Bordi do të kërkojë mbështetje dhe koordinim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për tejkalimin e kësaj situate dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të transmetuesit publik.

Radio Televizioni i Kosovës mbetet i përkushtuar ndaj misionit të vet publik, transparencës dhe informimit të drejtë të qytetarëve.

Rr. "Xhemajl Prishtina" Nr. 12., 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. +383 (0) 38 230 102, fax. +383 38 235 336, ëë.rtklive.com
FNr.: 600294657, PCB: 1110-012194-0001-59, SËIFT: MBKORS22